



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1038/Prot.
14

Tiranë, më 08.04.2025

V E N D I M

Nr. 47 datë 07.04.2025

“PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË NDRYSHIMIT TË SHPËRNDARJES SË TË
ARDHURAVE PËR KURSIN PROFESIONAL TË UDHËRRËFYESIT TURISTIK TË
SPECIALITETIT TË VEÇANTË - MODULI RAFTING,
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në nenin 38, të Ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UST -së neni 20, në VKM nr. 692 datë 05.10.2026 “Për miratimin e Rregullores për kriteret për paisjen me certifikatën për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat përgjegjësitë dhe kodi i Etikës”, në Udhëzimin nr. 517 datë 24.01.2017 “Për akreditimin e programeve për edukimin profesional në vazhdim”, në Vendimin e Senatit Akademik nr. 26 datë 17.05.2019 “Mbi miratimin e Rregullores së organizimit dhe funksionimit të kursit profesional të certifikimit të udhërrëfyesit të specialiteteve të veçanta”, në Vendimin e B.A. nr. 68 datë 17.10.2023 “Mbi një ndryshim dhe shtesë në Vendimin e B.A. nr.35 datë 21.10.2019 “Mbi miratimin e rregullores financiare dhe shpërndarjes së të ardhurave të UST” dhe miratimin e trajtimit financiar të stafit administrativ të angazhuar në mbarëvajtjen e QTFV dhe realizimin e modulit Raftin në UST”, në Vendimin e B.A. nr. 43 datë 31.10.2024 “Për miratimin e rregullores së brendshme për Administrimin Financiar, Kontabilitetin dhe Kontrollin në Universitetin e Sporteve të Tiranës” neni 7 , pika 5, gërma “d”, në shkresat e Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit nr. 832 Prot., datë 12.03.2025 të “Kërkesë për ndryshimin e shpërndarjes së të ardhurave për kursin profesional të Udhërrëfyesit Turistik të Specialitetit të Veçantë - Moduli Rafting” dhe shkresën nr. 832/1 Prot., datë 25.03.2025 “Argumentim mbi kërkesën për ndryshimin e shpërndarjes së të ardhurave për kursin profesional të Udhërrëfyesit Turistik të Specialitetit të Veçantë - Moduli Rafting”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 07.04.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, që shpërndarja e të ardhurave për kursin profesional të Udhërrëfyesit Turistik të Specialitetit të Veçantë - Moduli Rafting, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, të bëhet në koston reale të programit

dhe jo sipas përqindjeve të përcaktuara në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 43 datë 31.10.2024.

2. Të ardhurat e mbetura pas zbritjes së kostos për realizimin e këtij moduli, të kalojnë për llogari të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ky Vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të UST-së.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

